

Joint German-Danish "Support to Agriculture and Rural Economic Development of Disadvantaged Mountainous Areas" (SARED)



RAPORT

Datë, 29/07/2016

VC – Fruta & Arrore, Grupet (CD) Korçë, Dibër, Kukës
Periudha: 25-29 Korrik 2016

Korçë: Java e katërt 25-29 Korrik 2016, facilitatorët kanë ndjekur punën me grupet

Gjate kësaj jave të gjithë prodhuesit e rajonit të Korçës kanë intensifikuar shërbimet në pemtore të



mollës veçanërisht në ujitje dhe ushqimet gjethore pasi fruti i mollës është në fazën intensive të rritjes dhe përgatitet për fillimin e pjekjes, ku dhe kërkesat për ushqim janë maksimale. Gjithashtu nuk është larguar vëmendja nga shërbimet e mbrojtjes si kroma dhe krimbi i mollës (breznia e dytë) dhe shumë prodhues vazhdojnë me krasitjen e gjelbër verore (kjo e fundit e marrë shkas nga trajnimet e kryera prej ADAD). Për të gjitha këto shërbime në mënyrë të vazhdueshme si ADAD kemi asistuar dhe këshilluar grupet bashkëpunuese të projektit SARED.

Gjate gjithë javes janë informuar prodhuesit me të dhënat e tre qendrave prognoze sinjalizimit Dvoran, Pirg, Zvirine mbi shfaqjen e breznsisë së dytë të krimbit të mollës dhe kromës së mollës, në konsultë të vazhdueshme me QTTB Korçë dhe vërtetimin fushor të kurthit të ngritur në pemtoren e Sokol Dilka Voskop u bë shpërndarja e informacionit mbi fillimin e trajtimit kimik për luftimin e krimbit të mollës breznia e dytë.

Me grupin Qatrom-Dvoran; janë kryer vizita mbi krasitjen e gjelbër në pemtoret e Z. Agron Dvorani dhe Z. Evis Sheno, ku janë këshilluar për krasitjen e gjelbër për krijimin e kurorës, intensifikimin i ujitjes dhe ushqimit.



Me grupin Qafzez; janë kryer vizita mbi krasitjen e gjelbër në pemtoret e Festim Caushit dhe Aleks Aleks, ku janë këshilluar për krasitjen e gjelbër për krijimin e kurorës, intensifikimin i ujitjes dhe ushqimit.

Me grupin Bilisht-Borsh; vizita tek pemtoret e Mondhi Pasha dhe Ibrahim Hoxha, ku janë dhënë këshilla për krasitjen e gjelbër dhe konsultë teknike mbi shërbimet e kohës në pemtore për pesticidet, për trajtimet kimike, për kromën e mollës dhe krimbin. Gjithashtu

është bërë vlerësimi i pemtoreve, ku janë zbatuar këshillat e marra nga trajnimet e bëra nga ADAD, të cilat janë në gjendje shumë të mirë.

Joint German-Danish "Support to Agriculture and Rural Economic Development of Disadvantaged Mountainous Areas" (SARED)

Me grupin Zvirine-Pirg; me grupin u bë vizitë në pemtoren e Skënder Nurka, ku u fol për shërbimet në ujitje dhe për ushqim gjethor i cili mund të përzihet me insekticid, në mënyrë që fermerët të bëjnë një spërkatje dhe jo dy, duke ndikuar në uljen e kostos së prodhimit.

Me grupin Vranisht; Vizitë pune në grupin e prodhueseve tek pemëtorja e Urim Gegollit, për konsultë teknike mbi shërbimet në pemtore trajtimi kimik me insekticid në luftën e breznisë së dytë për krimbin e mollës dhe konsultë teknike për krijimin e një pemtoreje të rë arre sip 6-7 dyn për vjeshtën që po vjen.

Dibër: Për tre grupet VC Dibër (Ushtelenxe, Tomin, Kastriot)

Në vazhdim facilitatori ka mbajtur kontakte të vazhdueshme për të nxitur zbatimin e këshillave dhe për ujitjen dhe plehrimin gjethor në mollë dhe krasitjen e gjelber. Ai ka organizuar takime me grupe të vogla në Tomin, Kastriot dhe Ushtelenxë dhe ka vlerësuar gjendjen e pemtoreve duke identifikuar sëmundjet dhe dëmtuesit në mollë (këpusha e kuqe dhe morri i përgjakshëm), kumbull (njollosja e kuqe). Ka asistuar prodhuesit për trajtimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve, ujitjen etj. Facilitatori ka vizituar 8 ferma (Florin Torba, Bilbil Zebi, Femi Zebi, Veip Salkurti, Hajri Kaloshi, Rami Begu, Shehat Zollumi,) për tre grupet dhe ka kontaktuar të gjithë pjesëtarët e grupeve, gjithashtu ka nxitur të realizojnë krasitjen e gjelbër dhe kryerjen e shërbimeve të ujitjes, veçanërisht të qershisë. Në takime kanë marrë pjesë dy specialistët e DB Dibër, Jahja Ashiku dhe Avni Koltraka.

Kukës: Për tre grupet VC Kukës (Tregtan, Fajza, Vranisht - Golaj, Zaharisht)

Has: Në vazhdim facilitatori ka mbajtur kontakte të vazhdueshme për të nxitur zbatimin e këshillave për krasitjen e gjelbër tek kumbulla varieteti Tropojane. Ka organizuar takime me grupe të vogla në Tregtan, Fajza, Vranisht dhe Golaj dhe kanë vlerësuar gjendjen e pemtoreve duke identifikuar sëmundjet dhe dëmtuesit në molle (kroma), kumbulla njollosja e kuqe, ndryshku tek dardha dhe tek arra (pikëzimin i gjethes). Ka asistuar prodhuesit për trajtimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve, ujitjen etj. Janë vizituar 8 ferma dhe janë kontaktuar të gjithë pjesëtarët e grupeve.

Kukës: Gjate kësaj jave facilitatori ka vazhduar takimet me fermerët e grupit duke u dhënë këshilla



dhe trajtimet kimike sipas rekomandimeve përkatëse.

mbi krasitjen e gjelbër në kumbull (varieteti Tropojane), si dhe mbrojtjen e pemëve nga sëmundjet dhe dëmtuesit e ndryshëm. Takimi kryesor është zhvilluar në fshatin Nage në pemtoren e mbjellë me kumbull, të fermerit Naim Doci, ku ishin pjesëmarrës dhe fermerë të tjerë të grupit. Në takim ishte pjesëmarrës edhe specialist i DB Kukës Z. Sherif Visha. Janë bërë vizita në terren për 6 prodhues dhe të gjithë fermerët e grupit janë këshilluar për vadijen e pemtoreve